

Java Europiane e Vaksinimit

23-29 Prill 2018

TË MBROJTUR SË BASHKU

Vaksinimi është një e drejtë personale por një përgjegjësi e përbashkët!

Java Europiane e Vaksinimit ofron një mundësi që, në vende të ndryshme në prill të çdo viti, të promovohet rëndësia dhe përfitimet që Shëndeti Publik ka nga vaksinat. Që në fillimet e saj në vitin 2005, Java Europiane e Vaksinimit ka arritur të bëhet një ngjarje e rëndësishme me shtrirje të gjerë në rajon, duke përfshirë qindra iniciativa që rrisin ndërgjegjësimin mbi këtë çështje.

Zbatimi i gjerë i programeve të vaksinimit gjatë 30 viteve të fundit ka çuar në një rënie drastike të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë, të shkaktuara nga sëmundjet që parandalohen nga vaksinat.

Rajoni europian vazhdon të gëzojë një mbulesë vaksinale të lartë gjatë fëmijërisë, megjithatë një numër jo i vogël fëmijësh nuk po marrin mbrojtjen vaksinale të nevojshme, duke shërbyer si transmetues të infeksioneve tek personat e tjerë.

Fakte :

- Vaksinimi mbron nga sëmundje të tilla si: hepatiti, fruthi, difteria, pneumonia, shytat, poliomieliti, kolla e mirë, rubeola, tetanozi, diarreja nga rotavirusi dhe kanceri i qafës mitrës etj., sëmundje të cilat nëse nuk parandalohen nga vaksinat mund të lënë paaftësi e të çojnë deri në vdekje.
- Në 2016, 1 në 15 fëmijë në rajon nuk u vaksinua me dozën e parë të vaksinës së Fruthit dhe 1 në 21 fëmijë nuk morën asnjë dozë të vaksinës së Difteri-Tetanoz-Pertus. Këto hendeqe të krijuara kanë çuar në shpërthime të fruthit që mund të shmangeshin nga vaksinimi.
- Mbulesa vaksinale globale ka arritur në 86%, pa pësuar ndryshime sinjifikante gjatë viteve të fundit.
- Vaksinimi mund të evitojë përafërsisht 2-3 milion vdekje çdo vit. Nëse mbulesa vaksinale do të përmirësohej atëherë do të parandaloheshin edhe 1,5 milion vdekje të tjera.
- Megjithatë 19.5 milion fëmijë në mbarë botën nuk po marrin vaksinimin e duhur.

Fokusi i fushatës së 2018-s

Të gjithë mund të ndihmojnë për të pakësuar boshllëqet e krijuara në imunizim. Fokusi i fushatës së Javës Europiane të Vaksinimit është: vaksinimi është një e drejtë personale por një përgjegjësi e përbashkët, ndaj nën sloganin **TË MBROJTUR SË BASHKU**, bëhet thirrje për vaksinim të çdo individi, pa lënë askënd pas.

Vaksinat të mbrojnë ty dhe kedo përreth teje

Vaksinat sigurojnë mbrojtje individuale nga shumë sëmundje të rrezikshme, por përfitimi prej tyre nuk mbaron aty. Kur i gjithë komuniteti është i vaksinuar, nuk mbetet asnjë person që mund të transmetojë sëmundjen ngjitëse tek personat më të rrezikuar për të shfaqur ndërlikime serioze. Pra duke u vaksinuar të gjithë, së bashku ne mund të mbrojmë personat më vulnerabël (të prekshëm), përfshirë foshnjat. Çdo person meriton të imunizohet dhe ndan përgjegjësinë sociale për të mbrojtur ata që nuk mund të mbrojnë veten.

Vaksinimi na mban ***TË MBROJTUR SËBASHKU***,